



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1278/1 Prot.

Durrës, më 28.7 2023

VENDIM

Nr. 41, datë 28.7 2023

"Miratimi i pagesës së orëve mësimore të realizuara mbi mësimdhënien e normuar vjetore për vitin akademik 2022-2023, nga personeli akademik me kohë të plotë i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës

Bazuar në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Insitucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 748, datë 11.06.2009, "Për trajtimin me pagë të personelit akademik në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Udhëzimin nr. 29 datë 09.10.2018, të ndryshuar, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë", shkresës nr.1237 prot., datë 19.07.2023 të Rektorit "Përcillen për miratim 200 orët suplementare të realizuara në auditor nga lektorët me kohë të plotë për vitin akademik 2022-2023", shkresën nr. 1233/5, datë 25.07.2023 të Administratorit, relacionin e hartuar nga Drejtoria e Administrimit Financiar, Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Miratimin e pagesës në masën deri në 200 orë mësimore të lejueshme mbinormën mësimore vjetore për orë mësimore të realizuara brenda auditorit, për vitin akademik 2022 – 2023, për personelin akademik me kohë të plotë, për pesë fakultetet e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës sipas Udhëzimit nr. 29 datë 09.10.2018, të ndryshuar, "Për veprimtarinë dhe ngarkesën mësimore të personelit akademik në Institucionet e Arsimit të Lartë".
2. Miratimin e pagesës mbi limitin 200 orë mësimore deri në 300 orë mësimore të realizuara në auditor, si orë mësimore suplementare të realizuara brenda auditorit, për vitin akademik 2022 – 2023 për personelin akademik me kohë të plotë për pesë fakultetet e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, vetëm në rastet specifike pas verifikimit të dokumentacionit shoqërues, propozimit të drejtuesit të Njesisë bazë dhe miratimit nga drejtuesi i Njesisë kryesore.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Administratori
 - Drejtoria e Adminsitrimit Financiar
 - Drejtoria e Kurrikulës dhe Standarteve të Cilësisë
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I BORDI TË ADMINISTRIMIT

Ada ALIAJ

